



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 171 Prot

Tiranë, më 11.12. 2009

VENDIM Nr. 15 dt. 03.12.2009

Në mbështetje të nenit 17, pika 6, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, ndryshuar me ligjin nr. 9882, dt 28.02.2008, “Për Trashëgiminë Kulturore”, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve në mbledhjen e datës 03.12.2009, pasi shqyrtoi projektet e diskutuara nga Këshilli Shkencor pranë Institutit të Monumenteve të Kulturës:

VENDOSI:

Lidhur me: Diskutim i projekteve (subjektet private)

1. **Nuk u diskutua:** Kërkesë për rikonstrukcion banese me pronar Fatmir Lame, Elbasan.
2. Kërkesë për ndërtim banese pranë lagjes kala, Elbasan, Fidelino Halo. **Miratohet më vërejtjen: (Objekti të mbulohet me çati. Gjatë hapjes së themeleve të jetë nën vëzhgimin e ASHA-s.**
3. **Miratoi:** Projekt përshtatje fasade për banesën me pronar Zenel Sheshalliu, Zona tampon, Berat.
4. **Miratoi:** Projekt rikonstrukcioni për banesën e Vangjel Felahut, lagja 10 Korriku, Berat.
5. **Miratohet:** Projekt restaurimi i kompleksit të familjes Nikolin Ujka, Shkodër.
6. **Miratohet:** Projekt rikonstrukcioni + shtesë kati+ shtesë volume ne zonen Tampon, lagjja “10 Korriku”, Berat. Ambjente banimi dhe sherbimi (dyqan) me bodrum, Pronaret: A. Xhimitiku , K. Trendafili.
7. Projekt për ndërtimin e një Bar-Bufe, zona Tampon (Qafë e Kalasë), objekt i qytetarit Haxhistasa, Berat. **Projekti miratohet me vërejtjet.**
 1. **Miratohet si zgjidhje provizore.**
 2. **Sheshi të mos shtrohet me asfalt, por të jetë e shtruar me bar. Kjo të shënohet në specifikimet teknike**
8. **Nuk u miratua:** Projekt përshtatje dhe rikonstrukcion i banesës së Sotir Koli Bualit, lagjia 13 shtatori, zona Tampon, Berat.
9. **Nuk u diskutua:** Projekt restaurimi Manastiri i “Shën Prodhomit”, Voskopojë
10. **Miratohet me vërejtjen: Të qëndrojë llozha, të hiqen ballkonet, projekti:** Rikonstrukcion banese dhe shtesë kati i banesës së Aleko Përgjika, lagjia nr.12, rruga “Veteranët”, nr.26, Korçë.

11. **Miratohet:** Projekt rikonstruksioni dhe përshtatje e kompleksit të banesave të djegura, lagjia Goricë, Berat.
12. **Miratohet:** Zëvendësimi i çatisë së drurit, me soletë beton arme, për banesën e pronarit Arben Biçoku, Berat.
13. **Nuk u miratua.** Projekt përshtatje, e pamjeve zona tampon hotel “DASARET”, me pronar Ilir Sulanji, Berat. **Të plotësohet dokumentacioni ligjor dhe të ridiskutohet në mbledhjet e ardhshme)**
14. **Lidhur me:** Studimi fotogrametrik i Kalasë së Beratit (paraqitur nga PACARD).
 1. Duhet asistencë nga ana e IMK.
 2. Duhet të aprovohet një marrëveshje në parim mes dy palëve. Projekti do të ridiskutohet në mbledhjet e ardhshme.
15. **Miratohet:** Projekt restaurimi banesa Kristo Kamberi, Gjirokastër.
16. **Miratohet me vërejtjen: Të mos bëhen ndërhyrje në themele, të punohet mbi themelet ekzistuese,** Projekti i ngritjes të një kati në banesën ekzistuese me pronar Dhimitër Kaleshi në lagjen “Kala”, Elbasan,.
17. Projekt restaurimi përmirësimi i pamjes së jashtme të ish dyqanit të luleve M 050, lagja Mangalem, Berat. **Projekti miratohet me vërejtjet:**
 1. **Projekti të cilësohet projekt përshtatje.**
 2. **Miratohet për një afat të përkohshëm.**
 3. **Në afatin kohor për 12 muaj, ngarkohet IMK të hartojë një projekt final permanent, për të përshtatur objektin, në përputhje me legjislacionin.**
18. **Miratohet:** Projekti i hapje porte dhe dritare në objektin Art Studio (ish aneksi i shkollës 7 Nëntori), me pronar Z. Agron Polovina M 110, lagja Mangalem, Berat.
19. **U diskutua dhe miratua jashtë rendit të ditës së KKR, por i diskutuar dhe miratuar nga Këshilli Shkencor i IMK projekti:** Rikonstruksioni i banesës me pronar Bik Preka, në rrugën Kardinal Koliqi, Shkodër.

- Ngarkohet sekretaria teknike, për njoftimin e këtij vendimi.
- Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R
FERDINAND XHAFERRI

SEKRETAR I KKR
PROF. DR. VALTER SHTYLLA